



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**PËR**

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 112, DATË 27.03.2019 "PËR SHPALLJEN E REZULTATIT TË SHORTIT PËR EMËRIMIN E EKSPERTËVE KONTABËL TË LIÇENSUAR, TË CILËT DO TË KRYEJNË AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFTUARA DHE TË SHPENZUARA NGA PARTITË POLITIKE PËR VITIN KALENDARIK 2018"**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 07.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

**OBJEKT:** Për një shtesë në vendimin nr. 112, datë 27.03.2019 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të liçensuar, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, për vitin kalendarik 2018".

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1 germa a, të ligjit nr. 10019, datë 29.02.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 15/2, pika 2, germa c, neni 23/2, pika 2 dhe neni 23/3 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.02.2011 dhe Udhëzimi i Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nr. 8, datë 25.03.2009 "Për miratimin e kriterëve dhe procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të liçensuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore " i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi propozimet e paraqitura si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike;

**V Ë R E N:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 27.03.2019, në prani të përfaqësuesve të partive politike, ekspertëve kontabël të liçensuar, si dhe mediave, organizoi shortin për emërimin e ekspertit kontabël të liçensuar, i cili do të auditojë fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga



**Nr.249 i Vendimit data 07.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e Vendimit**

Për një shtesë në vendimin nr. 112, datë 27.03.2019 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të liçensuar, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, për vitin kalendarik 2018".

partitë politike përkatëse. Procedura e organizimit të shortit u zhvillua sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 8, datë 25.03.2009, i ndryshuar, të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve. Në një enë transparente u futën 23 gogla, ku në secilën prej tyre, në një shirit letre është shënuar emri i secilit prej ekspertëve kontabël të licensuar pjesëmarrës. Në enën tjetër u futën 112 gogla dhe në secilën prej tyre u fut një shirit letre ku ishin shënuar respektivisht emrat e 112 partive politike.

Në fillim të vitit kalendarik Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, dërgon në KQZ listën e partive politike të rregjistruara. Sipas shkresës protokolluar me nr.18/1, datë 21.01.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, për Partinë Politike "Lista e Barabartë", me vendimin nr.1036 Akti 11.12.2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur sigurimin e padisë duke pezulluar dhe ndaluar kryerjen e të gjitha veprimtarive juridike, financiare dhe organizative brenda Partisë Politike "Lista e Barabartë", me iniciale "Libra" si dhe çdo veprim bankar dhe veprimet e tjera me të gjitha institucionet e treta në emër të Partisë "Libra" të shtetasit Endri Tafani dhe personave të autorizuar prej tij.

Në këto kushte Partia "Libra" u përjashtua nga shorti për caktimin e ekspertit kontabël të licensuar për auditimin e fondeve për vitin kalendarik 2018.

Me shkresën e protokolluar me nr.2146, datë 03.04.2019 në Komision Qendror të Zgjedhjeve të Partia Lista e Barabartë ka paraqitur kërkesën për rregjistrimin e saj si subjekt zgjedhor, duke bashkëlidhur dhe vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr. 4, datë 15.03.2019

Me vendimin nr.4 , datë 15.02.2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes nr.15 akti datë rregjistrimi 23.11.2018, heqjen e masës së sigurimit të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1025, datë 27.11.2018 të partisë politike Lista e Barabartë, duke ia kthyer të drejtën për kryerjen e të gjitha veprimeve juridike, financiare dhe organizative partisë politike "Lista e Barabartë" si dhe çdo veprim bankar dhe veprimet e tjera me të gjithë institucionet e treta në emër të kësaj partie.

Për arsyet e mësipërme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do organizojë shortin për caktimin e ekspertit kontabël të licensuar për auditimin e fondeve për vitin kalendarik 2018, Partinë "Lista e Barabartë" dhe në Vendimin e KQZ-së, nr. 112, datë 27.03.2019, të shtohet dhe emërimi i ekspertit kontabël të licensuar, për këtë parti politike, të cilëve në shortin që u zhvillua nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 27.03.2019, tre ekspertë kontabël sipas rezultatit të shortit do të auditojnë një numër më të vogël partish. Në këto kushte do të hidhet shorti për auditimin e fondeve të përfutuara dhe të shpenzuara ndërmjet Partisë "Lista e Barabartë", dhe ekspertëve z.Shkëlzen Margjeka, znj.Silvana Gjikhima, znj.Rajmonda Reveli.

Gjithashtu, në bazë të pikës 1 të nenit 23/3 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar, përcaktohet se eksperti kontabël nuk mund të auditoj të njëjtën parti dy vjet njëri pas tjetrit.

## **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1 gërma a, të ligjit nr.10019, datë 29.02.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 15/2, pika 2, germa c,



### **Nr.249 i Vendimit data 07.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e Vendimit**

Për një shtesë në vendimin nr. 112, datë 27.03.2019 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfutuara dhe të shpenzuara nga partitë politike, për vitin kalendarik 2018".

neni 23/2, pika 2 dhe neni 23/3 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.02.2011 dhe Udhëzimit nr.8, datë 25.03.2009 "Për miratimin e kriterëve dhe procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të liçensuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore" i ndryshuar, të Komisionit Qendror i Zgjedhjeve

### **V E N D O S I:**

- 1.** Të miratojë rezultatin e shortit dhe të emërojë ekspertin kontabël të cilët do të auditojë partinë politike "Lista e Barabartë" për fondet e përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2018, z.Shkelzen Margjeka.
- 2.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- 3.** Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e këtij vendimi

<b>Klement</b>	<b>ZGURI-</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA-</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr.249 i Vendimit data 07.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e Vendimit**

Për një shtesë në vendimin nr. 112, datë 27.03.2019 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të liçensuar, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, për vitin kalendarik 2018".